

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**-Departamenti për te mitur, Kryetarja e trupit gjykues për te mitur Pranvera Ademi, me sekretaren juridike Xhyla Aruçi, në çështjen penale kundër te akuzuarit B S per shkak te veprës penale Sulmi seksual nga neni 195 par.2 pika 1 e 2 lidhur me nenin 20 te KPK, duke vendosur sipas aktakuzës se Prokurorisë Publike te Qarkut ne Mitrovicë PP.nr.288/2009 te dt.17.05.2010, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar te datës 08.02.2016, i cili ishte verbal dhe publik, te shpallur me date 08.02.2016, ndërsa i përpiluar me dt.09.02.2016 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Kundër te akuzuarit:

B S, me nofkën „B”, nga i ati B, e ëma F, e vajzërisë O, i lindur me datë 00.00.0000 ne Runik, Skenderaj, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, i martuar baba i dy fëmijëve, punon ne shtetin e Belgjikës, si vozitës ne firmën ndërtimore „Pulsën”, ka te kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes se mesme ekonomike.

**Ë S H T Ë F A J T O R E**

**SEPSE:** Me datë 21.07.2009 rreth orës 18,00 ne motelin ne fshatin Pemishte – Skenderaj me force dhe kërcenim te rrezikimit te drejtpërdrejtë te jetës dhe trupit e për qëllim seksuale e ka prek te dëmtuarën S A, ashtu qe me një dore e ka kapur viktimën mbrapa për flokëve, e ka puth ne goje pa pëlqimin e saj, viktima i kundërvihet duke u mbrojtur dhe u larguar mirëpo i akuzuari ka vazhduar duke e mos e lëshuar, mirëpo kur vëren se e dëmtuara bene rezistence dhe te njëjtës nuk mund t’ia then rezistencën te njëjtën e liron duke i thënë qe te qëndroj ne dhome e pastaj, i dyshuar ne prezencën e viktimës bene marrëdhënie seksuale me te dyshuarën S B.

-Me këtë ka kryer veprën penale Sulm seksual nga neni 195 par 2 pika 1 e 2 e lidhur me nenin 20 te KPK.

Andaj, gjykata në mbështetje te neneve 6, 11, 15, 34, 35, 41, 42, 43, 44 par 1 dhe 3, 64, 66 par 1 e 2 dhe nenit 195 par 2 pika 1 e 2 e lidhur me nenin 20 të KPK, e lidhur me nenet 248, 365 si dhe 450 par 1 e 2 nen par 2.6, 463 të KPPRK, te akuzuarin, e

**G J Y K O N**

**ME DENIM ME KUSHT** duke i përcaktuar te akuzuarit B S, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale.



Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 100 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor obligohet që të paguaj shumën prej 30 euro, e të gjitha këto është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara **Sejma Aliu**, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike përkatësisht kompensimin e dëmit udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### Arsyetim

Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.288/2009 të dt.17.05.2010 kundër të pandehurit **Bashir S. Stakaj**, për shkak të veprës penale Sulm seksual nga neni 195 par.2 pika 1 e 2 të KPK.

Gjykata për këtë lende penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 08.02.2016, në të cilin kanë qenë prezent Prokurori i shtetit Ismet Ujkani, i pandehuri **Bashir S. Stakaj** dhe mbrojtësi i tij av.Agim Lushta.

Prokurori Ismet Ujkani në seancën e shqyrtimit fillestar bënë cilësimin juridik të veprës penale e cila duhet të jetë edhe tentative nga neni 20, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuara.


I akuzuari **Bashir S. Stakaj** në shqyrtimin fillestar ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale Sulm seksual nga neni 195 par.4 lidhur me par.1 e 2 pika 1 e 2 e lidhur me nenin 20 të KPK.

Gjykata i ka tërhequr vërejtjen të akzuarit në lidhje me pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë. I pandehuri **Bashir S. Stakaj** edhe pas tërheqjes së vërejtjes prapë ka qëndruar pranë pranimit të fajësisë.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë Prokurori Ismet Ujkani, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi, pranimit të fajësisë mbështetet edhe në provat që gjenden në shkresat e lendes nga se rezultoi se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet. Andaj i propozon gjykatës që pranimit të fajësisë të pandehurit të aprovohet si dhe të shpallet fajtor për veprën e kryer penale duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Mbrojtësi i të pandehurit **Bashir S. Stakaj**, av.Agim Lushta, në shqyrtimin fillestar deklaroi se pas konsultimeve të mjaftueshme me të pandehurin, vullnetarisht dhe pa imponim i njëjti pranoi fajësinë dhe i propozon gjykatës që me rastin e shqyrtimit të dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë se hiqi dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, pranimit të fajësisë të klientit tim, faktin se në atë kohë ja qenë i ri dhe nuk ka ditur për veprimet e tij dhe pasojat që mund të sjellin ato. Nisur nga kjo i propozon gjykatës që të aplikoj dispozitat e nenit 67 par.1 pika 4 për zbutjen e dënimit dhe të shqipton një dënim sa më të butë me anë të se cilës do të realizohet qëllimi i dënimit.

Gjykata gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e vertetoi në bazë të pranimit të fajësisë nga vet i pandehuri, i cili pranimit ishte i mbështetur në nenin 248 par 1 nenpar 1 të KPP, dhe si i tillë ky pranimit i fajësisë është pranuar nga ana e gjykatës nga se i pandehuri i





kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare dhe mbështet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në provat materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe atë raportin fillestar të incidentit, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit të mitur S.A, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit D Q dhe procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit B S.

Prandaj Gjykata duke u mbështetur në këto fakte dhe prova ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale Sulmi seksual nga neni 195 par.2 pika 1 e 2 lidhur me nenin 20 të KPK.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, gjykata në vështrim të nenit 66 të KPK ka bërë zbutjen e dënimit meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë.

Sipas nenit 195 par.4 e lidhur me nenin 1 e 2 pika 1 të KPK, kryesi dënohet me burgim prej 1 deri në shtatë vjet.

Sipas dispozitës së nenit 67 par.1 pika 4 të KPK, nëse për veper penale është parapare si mase me e ulët dënim me burgim prej një viti, dënimi mund të zbutet deri në tre muaj burgim.

Duke zbatuar këtë dispozitë ligjore nëni 66 par.1. e 2 të KPP, ku përcaktohet se; gjykata mund të shqiptoj dënim nën kushtin e parapare me ligj që të shqiptoj lloj me të bute të dënimit kur ligji parasheh se dënim i kryesit mund të zbutet, ose kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësuese të cilat tregoj se edhe me dënim me të bute mund të arrihet qëllimi i dënimit.

rrethane renduese për të akuzuarin gjykata nuk gjeti, ndërsa si rrethane lehtësues ka marrë rrethanat nga neni 64 par.1 të KPK;

- i akuzuari me parë kishte sjellje të mira,
- e ka pranuar fajësinë,
- sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale ishin të mira,
- se ka shprehur keqardhje për veprën e cila ka ngelur në tentative.

Nga të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 34 i KPK, që;

- Te parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tij,
- Te përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata i mori konform nenit 450 të KPP.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil gjykata e mori në bazë të nenit 463 par 1 dhe 2 të KPP.



Nga si u tha me lart u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti per te mitur**  
**P.nr.208/2015 te datës 09.02.2016**

**Sekretarja juridike**  
**Xhyla Aruçi**



**Kryetarja e trupit gjykues për te mitur**  
**Pranvera Ademi**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës se Apelit ne Prishtine- Departamenti per te mitur, përmes kësaj gjykate.

Republika e Kosovës  Republika Kosovo


**SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON**  
**TACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE**

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

**VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM**  
**ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA**  
**GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD**  
**MITROVICË - MITROVICA**

Më  
Data

28.04.16 20



Punëtori i autorizuar  
Ovlaščeni radnik

